

BULETINI INNOVET ALBANIA

Le të kontribuojmë drejt një komuniteti më të fortë të Arsimit dhe Formimit Profesional!



I dashur lexues,
Jam e lumtur që në këtë fundvit po bëj hapjen e Buletinit të 12 Innovet. Unë quhem Aulona Hoxha dhe jam drejtuesja ekzekutive e Expocity Albania. Expocity Albania është një kompani që merret me organizimin dhe drejtimin e panaiere të ndryshme tregëtare sektoriale, ekspozita, B2B, dhe evente të veçanta në tregjet vendase dhe ndërkombëtare. Gjithashtu është një shoqëri e cila fokusin kryesor e ka në panaiere duke u munduar që të prekë sektorët kryesorë, të promovojë bizneset qoftë ato të reja apo lider. Këto panaiere shërbejnë si një urë lidhëse për krijimin e marrëveshjeve të reja ndërmjet kompanive apo dhe duke i ndihmuar ato ne percjelljen apo evidentimin e problematikave apo shqetësimeve që ato kanë duke ndikuar sa me pozitivisht.

Përgjatë realizimit të panairit të Turizmit ishte bashkëpunimi i parë me Albanian Skills, ku u realizua dhe konkursi për paketën më të mirë turistike të ofruar nga nxënës, studentë pjesëmarrës.

Realizimi i panaiereve në vetvete është një impenjim shumë i madh i cili kërkon një punë intensive të palodhur të një ekipi energjik i cili nuk i kursehet punës dhe realisht Expo city e ka një ekip të tillë të pa kursyer që deri më tani ka bërë një punë shumë të mirë.

Këto panaiere kanë sjellë disa risi mjaft të rëndësishme për profesionet, profesionistët bizneset apo aktorë të tjerë si:

- Shpalosje e talenteve të reja nepermjet konkurseve dhe aktiviteteve që zhvillohen;
- Promovim i bizneseve të reja dhe prezantimi më nga afër i produkteve apo shërbimeve që ato kanë/ofrojnë;
- Kontakti më i afërt me konsumatorin;
- Krijimi i urave lidhëse me biznese të huaja apo vendase për krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në të ardhmen;
- Fronte të reja pune;
- Pasqyrim i problematikave apo gjetja zgjidhje e tyre nëpërmjet konferencave apo takimeve ku prezent janë dhe figura të larta shtetërore;

Pjesëmarrja e të rinjve në konkurse apo aktivitetet të tilla i bën ato më të aftë dhe dominues të profesionit të tyre. Panaiert janë një urë lidhëse me bizneset, ne mundohemi që në çdo panair të rinjve t'i dedikojmë një hapsirë të veçantë dhe ti ofrojmë sa më shumë mundësi ndërmjetësimi me kompani të ndryshme.

Gjithashtu për t'u përmendur është dhe fakti se feedbacku i bizneseve në lidhje me aktivitetet që kemi zhvilluar ka qenë shumë pozitiv pasi bizneset gjithmonë janë në kërkim të të rinjve që janë ambicioz, të talentuar dhe kanë dëshirë të punojnë.

Në fund dëshiroj ta përmbledh këtë artiull me një mendim dhe dëshirë timen. Bizneset të jenë më zemërgjërë me të rinjtë duke i ofruar atyre më shumë mundësi punësimi qoftë full time apo part time. Kompanitë duhet t'i japin shancin të rinjve që ato të tregojnë aftësitë e tyre pavarësisht eksperiencës që mund të ketë në atë sektor. Të ofrojnë më shumë trajnime mbi pozicionet vakante, të jenë më elastik dhe fleksibël në krijimin e marrëdhëniet me të rinjtë.

Lexim të këndshëm!

©AlbanianSkills

Në këtë numër:

- Aulona Hoxha- Drejtuese e Expocity Albania
- Trego talentin tënd dhe bëhu një fitues!
- Agrotech - Konkursi i studentëve nga shkollat dhe universitetet profesionale, Zona e Konferencave.
- Përvoja që mbeten jo vetëm në kujtesën e nxënësve por edhe tonën, pasi garat i bëjnë nxënësit më të përgjegjshëm për të prezantuar me cilësi ide të tyre - Shkollës "Mihal Shahini" Çërrik në konkursin Agro Tech.
- AKTIVITETET E PROJEKTTIT INTERVET WB
- Job Shadowing i mësuesve në Maltë
- Lëvizshmëria afatshkurtër e nxënësve në Francë, Itali dhe Spanjë., nxënësit pjesëmarrës dhe shoqëruesja e grupit të Spanjes ndajnë përvojat e tyre
- 4 Transnational Meeting në Tiranë; Intervet WB
- Përvoja e studentëve italianë në realizimin e praktikës pranë kompanive shqiptare

Në numrin e ardhshëm:

- Nisma për Ekselencën në Arsimimin Profesional- Shqipëri.
- Takimet e para në Bologna, Itali, Dresden, Gjermani dhe Alba, Itali në kuadër të nisjes së tre projekteve të reja ERASMUS Plus, Rritja e Kapaciteteve në fushën e Arsimit dhe Aftësisht Profesional në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe Ministria Financave dhe Ekonomisë.
- Edicioni 8 të i Konkursit Kombëtar të Aftësive., Tirana Business Park -II Shkurt 2023.
- Aktivitete në kuadër të Expo Punësim dhe Aftësi Profesionale, International Tourism Fair 2023 dhe Energy Expo & Forum 2023., gjatë Shkurt-Mars 2023.
- Studentët nga Italia, përvojat e tyre gjatë qëndrimit dhe praktikave profesionale në Tiranë, Shqipëri, gjatë Shkurt-Mars 2023.
- Ditët e Karrierës pranë Bashkive Krujë, Kurbin, Tiranë, etj.

TREGO TALENTIN TËND DHE BËHU NJË FITUES!

Expocity Albania mbajti panairin e tretë ndërkombëtar të tekstit dhe lëkurës në vend gjatë 14-16 Tetor, 2022. Ky organizim kishte si synim kryesor mbështetjen e biznesit si dhe bashkëpunimin maksimal midis kompanive në rajon dhe jo vetëm.

Eventi zgjati tre ditë, ku u mbajtën forume, konkurse dhe konferenca të ndryshme midis përfaqësuesve të ndryshëm të sektorit.

Një nga aktivitetet e mbajtura ditën e shtunë me datë 15 Tetor ishte dhe konkursi “Trego talentin tënd dhe bëhu një fitues” i organizuar nga Albanian Skills në bashkëpunim të ngushtë me Expocity Albania dhe kompanitë pjesëmarrëse në panair.

Në këtë konkurs morën pjesë 15 të rinj nga e gjithë Shqipëria të apasionuar ndaj modës, stilimeve dhe dizanjit, të cilët vinin nga Shkolla Profesionale “Isuf Gjata” Korçë, Shkolla Profesionale TIK “Herman Gmeiner” Tiranë; Universiteti Politeknik i Tiranës, Gjimnazi “Havzi Nela” Kukës, Albanian Design Academy etj.

Fillimisht nxënësve ju prezantua tematika e konkursit, vendi i realizimit dhe rregullat e konkurimit dhe vlerësimit. Detyra që konkurrentët kishin ishte që të realizonin një skicim, dizanjin duke përfshirë dhe një nga simbolet si lule, rombe, forma të ndryshme të dhëna dhe shpjeguara hollësisht nga anëtarja e jurisë njëkohësisht përfaqësuese e kompanisë “Emar Design” Arlinda Baci Graphic Designer dhe Sipërmarrëse dhe anëtare e jurisë.



Konkurentët punuan për rreth 2 orë duke krijuar sipas imagjinatës së tyre dhe njëkohësisht duke shprehur talentin e tyre. Përgjatë gjithë kohës së konkurimit pjesëmarrësit ishin shumë entuziastë e të lumtur për pjesëmarrjen, pasi për ta dëshira për të skicuar ishte shumë e madhe aq sa siç shprehet dhe njëra nga konkurentet se “Dhe po të kaloj orë të tëra duke skicuar nuk mërzitem asnjëherë pasi ora më fluturon shpejt.”

Pas përfundimit të skicimeve, punëve nga të gjithë konkurrentët juria e përbërë nga ekspertë të fushës dha vlerësimet e saj:

1. Aulona Hoxha- Drejtoreshë Ekzekutive Expocity Albania
2. Ana Zacharian- CEO Albanian Skills
3. Arlinda Baci- Sipërmarrëse dhe Drejtore Dizajni dhe Marketing, Emar Design Shpk,
4. Edvin Prenc- Kryetar Shoqate Proexport Albania
5. Genti Mehmeti- Administrator DBS Group
6. Diana Cankuli- Administratore Blead
7. Kriton Prendi- Administrator Caterina Fienze
8. Tatjana Spahiu- Prof. nga Universiteti Politeknik
9. Manjola Misiri- Administratore Luisol



Të gjithë konkurrentët pjesëmarrës u vlerësuan nga anëtarët e jurisë për talentin e tyre dhe në mbyllje të aktivitetit ato shpërndanë certifikata për të gjithë pjesëmarrësit. E shtuna ishte një ditë e mbushur me emocione të bukura por dhe me krijime fantastike. Të rinjtë talentuar që do te ecin shumë përpara në karrierën e tyre.

Ne si Albanian Skills falenderojmë pjesëmarrësit që morën pjesë në konkurs, jurinë e cila vlerësoi por dhe ndihmoi, motivoi, këshilloi të rinjtë. Falenderojmë Expocity Albania që organizon panaiere të tilla ku të rinjtë mund të gjejnë veten mjaft mirë dhe të afrohen më shumë me bizneset e fushave të ndryshme.



AGROTECH - KONKURSI I STUDENTËVE NGA SHKOLLAT DHE UNIVERSITETET PROFESIONALE, ZONA E KONFERENCAVE

Edicioni i III-të i Panairit Ndërkombëtar të Agrobiznesit dhe Agroteknologjisë AGROTECH Expo 2022, i organizuar nga Expocity Albania, u zhvillua në datat 24-26 Nëntor, 2022. Ky panair ofroi një platformë komunikimi biznesi për aktorët më të rëndësishëm kombëtarë, rajonalë e ndërkombëtarë, në sektorët e makinerive bujqësore, kimikateve, plehrave kimike, agropërpunimit, konservimit, magazinimit, ambalazhimit, paketimit të produkteve bujqësore dhe transportit, ushqimitorganik dhe agroturizmit.

Përgjatë këtij panairi më 26 Nëntor u realizua dhe Konkursi Agrotech i organizuar nga Albanian Skills në bashkëpunimin të ngushtë me Agjensinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), shkollave profesionale të profilin bujqësor dhe Expocity Albania ku morën pjesë 9 grupe konkurrentësh.



Pjesëmarrësit në këtë konkurs specifikisht ishin:

- Shkolla e Mesme Profesionale "Ndre Mjeda" e cila u përfaqësua nga nxënësit: Anjeza Marku, Antoneta Prenga, Serxho Kolndrekaj të cilët u prezantuan me temën "Plehërimi me bimën "Komfrej" si plehërim baze dhe plotësues për kulturat bujqësore".
- Shkolla Profesionale Bujqësore Kamëz e cila u përfaqësua nga nxënësit: Sulejman Truka, Relando Hajdini, Klajdi Sulku të cilët prezantuan temën e "Kopshti Botanik".
- Shkolla e Mesme Kombëtare e Agrobiznesit Golem "Charles Telford Erickson" (CHTE Golem) e cila u përfaqësua nga nxënësit: Blerim Tlila, Ronaldo Stafa, Emine Doka, Marinela Tafa të cilët prezantuan temën për "Prodhimin e energjisë elektrike në funksion të buqësisë".
- Shkolla e Mesme "Mihal Shahini", Cërrik (Kopshtaqe) që u përfaqësua nga nxënësit: Ferdinand Haka, Halim Venari, Rei Miraka, Ergys Sadushi të cilët prezantuan temat: "Teknologjia e përgatitjes së fidanëve në Hidroponia dhe Kopshtet vertikale".
- Shkolla e Mesme Bujqësore "Rakip Kryeziu"(Çlirim) (3 R) që u përfaqësua nga nxënësit: Arjol Belshaku, Ervaldo Myrtaj, Emiljano Toska, Aleksander Ruko, Julian Kocaqi të cilët prezantuan temën e "Sistemit të integritetit të akuakulturës, hidroponisë dhe avikulturës".
- Shkolla e Agrobiznesit "Irakli Terova" (Fidanishtja Digjitale) që u përfaqësua nga nxënësit: Elsa Çobani, Mikel Bylygbashi, Ervin Bregolli të cilët prezantuan temën "Fidanishtja Dixhitale".
- Shkolla Tekniko-Profesionale "Enver Qiraxhi" Pogradec që u përfaqësua nga nxënësit: Griselda Sallo, Erisa Beleshko, Armando Beleshko, Jorgo Pere të cilët prezantuan temën "Përshtatshmëria e llojit dhe ruajtja e aromës".



Konkursi ndërmjet pjesëmarrësve zgjati rreth 1 orë ku çdo grup shfaqti nëpërmjet mënyrave të ndryshme idetë e tyre duke dhënë dhe një zgjidhje për situatën e për zgjedhur. Një garë e bukur, emocionuese, sfiduese ndërmjet konkurrentëve të cilët e prezantuan denjësisht idenë e tyre duke bërë dhe një prezantim shumë të mirë të shkollës së tyre dhe jo vetëm.

Ky konkurs ishte një mundësi që nxënësit të vendosnin në mënyrë praktike ato çfarë ato kanë mësuar në teori duke garuar me njëri tjetrin por dhe duke u gjykuar nga bizneset pjesëmarrëse të fushës së Agrobiznesit të cilët ishin pjesë e jurisë.

Juria përbëhej nga përfaqësues të kompanive :

- Agro Help
- Agro Harizi
- Agro Alaska
- INDA shpk
- Agromateo Albanian

të cilat dhuruan edhe kuponat fitues të barasvlefshme me materiale e lëndë të parë për shkollën fituese.

Pjesëmarrja në konkurse të tilla si Agrotech, shërbejnë si ura të shkëlqyera lidhëse ndërmjet nxënësve dhe bizneseve të fushës. Gjithashtu, nxitja e mendësisë së punës në ekip, shpirtit të garës, ekselencës në aftësi dhe profesion, është një eksperiencë me shumë vlerë për të gjithë nxënësit duke i përgatitur, stërvitur për tregun e punës me të cilin do të përballen në të ardhmen.





Për ne si Albanian Skills është kënaqësi që të organizojmë konkurse me të rinjtë dhe falenderojmë pafund për bashkëpunimin Agjensinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Expocity Albanian, shkollat dhe konkurrentët pjesëmarrës që me idetë e tyre i dhanë ngjyra, emocione të bukura. Gjithashtu falenderojmë bizneset pjesëmarrës të cilët me anë të këshillave i dhanë motivim dhe shtysë konkurrentëve pjesëmarrës dhe vullnetarët të cilët janë mbështetje shumë e madhe në çdo aktivitet që ne realizojmë.



Përvoja që mbeten jo vetëm në kujtesën e nxënësve por edhe tonën, pasi garat i bëjnë nxënësit më të përgjegjshëm për të prezantuar me cilësi idetë e tyre - Shkollës "Mihal Shahini" Çërrik në konkursin Agro Tech

Konkursi i zhvilluar më 26 Nëntor 2022 në Expocity mes shkollave bujqësore në Shqipëri ishte një përvojë shumë tërheqëse. Ky konkurs vuri para podiumit nxënës të shkollave bujqësore të cilët propozuan idetë e tyre në fushën e bujqësisë. Shkolla jonë e cila u përfaqësua nga një grup nxënësish të vitit të 2-të të drejtimin Bujqësi prezantoi idetë mbi hidroponinë dhe kopshtet vertikale, dy ide të cilat janë jo vetëm praktike për t'u ndërtuar por edhe në mbrojtje të mjedisit. Grupi filloi punën pas komunikimit me Albanian skills dhe Akpa të cilët vazhdimisht orientuan grupet e punës në lidhje me konkursin. Idetë erdhën nga vetë nxënësit dhe u prezantuan nga ata.

Nën drejtimin e prof. Petref Halili në profesion agronom, ekipi pjesëmarrës u përfaqësua nga nxënës: Ferdinand Haka, Alim Venari, Ergys Sadushi dhe Rei Miraka nxënës të drejtimin Bujqësi klasa 10-11. Nga njohuritë e deritanishme nxënës u përqendruan pikërisht në këto dy projekte pasi janë nga njera anë pjesë e studimit të tyre por edhe rendesia dhe roli që duhet të kenë këto dy teknika të kultivimit.

- Hidroponia është një mënyrë për të kultivuar me ujë dhe pa sipërfaqe toke, duke prekur kështu një nga problematikat që sot ka bujqësia, shfrytëzimi i mjedisit dhe materialeve të riciklueshme në ndihmë të prodhimeve më të kontrolluara për konsumatorin.

- Gjithashtu dhe kopshtet vertikale të cilët gjithkush mund t'i ketë në mjedisin ku jeton.



Gjatë ditës së konkurimit nxënësit krijuan lidhje jo vetëm me nxënës të shkollave të tjera por edhe me bizneset të cilët këtë ditë ishin me të vërtetë bashkëpunues.

Këto përvoja mbeten jo vetëm në kujtesën e nxënësve por edhe tonën, pasi gara i bëri me të përgjegjshëm për të prezantuar me cilësi idetë e tyre.

Gjatë konkursit nxënësit e shkollës mbështetën vazhdimisht shokët e tyre dhe në përfundim të konkursit emocionet i pushtuan të gjithë pjesëmarrësit.

Fituesit ishin nxënës të shkollës sonë të cilët kishin punuar mirë dhe sollën jo vetëm ide por edhe zgjidhje praktike si mund të gjejmë dhe të kemi qëndrueshmëri në mbrojtje të mjedisit.

Maketet me të cilat nxënësit demonstruan idetë e tyre sot janë vendosur në shkollë për të gjithë vizitorët që dëshirojnë të shohin aftësitë e nxënësve në praktika profesionale.

Këto përvoja nxitën jo vetëm konkurimin por edhe ngacmimin për të sjellë zgjidhje praktike në mbrojtje të mjedisit . Prandaj motoja e shkollës ka vetëm një kuptim: KUJDESEMI PER JETEN!



AKTIVITETET E PROJEKTIT INTERVET WB

Job Shadowing i mësuesve në Maltë

Miruar në vitin 2019, projekti INTERVET WB do të lejojë 54 mësues ose staf/menaxher administrativ nga të gjitha shkollat e AFP-së të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja) të kryejnë një stazh 7 ditor jashtë vendit. Mësuesit e përzgjedhur udhëtuuan drejt Maltës ku patën një eksperiencë ndryshe në kompanitë atje. Më poshtë do t'ju japim eksperiencat që kanë pasur mësueset pjesë marrë se në këtë praktikë pune.

Përshëndetje unë quhem Alda Kadiu mësuese pranë shkollës profesionale “Nazmi Rushiti” Pershkopi. Unë isha pjesëmarrëse në Praktikën e realizuar në Maltë.

Java e eksperiencës në Maltë shkoi në mënyrë perfekte si në aspektin e organizimit ashtu edhe në aspektin e përfitimit profesional.

Gjithshka ishte planifikuar në detaje nën kujdesin e përfaqësuesve të INTERVET Albania, Albanian Skills dhe drejtorit të projektit në Maltë: Ing. Louis Aquilina dhe Mr. Joshua Bugeja me të cilët patëm një bashkëpunim shumë të frytshëm dhe ndamë shumë mendime, opinione dhe eksperiencë si në aspektin social edhe atë profesional.



Alda Kadiu- Shkolla e mesme profesionale “Nazmi Rushiti” Pershkopi



Udhëtimi deri në Maltë ishte organizuar me dy fluturime nga Mynih, në aeroport na pritën për të siguruar udhëtimin deri te hoteli (i cili ishte me kushte shumë të mira dhe i pozicionuar pranë detit). Çdo ditë në orën 8:00 ishte organizuar udhëtimi nga hoteli te kampusi ku kryheshin trajnimet dhe nga kampusi te hoteli. Ishin organizuar takime në qendrën industriale Trelleborg, vizita kulturore në atraksionet e Maltës si në Valleta ku u njohëm me kulturën, traditën, historinë e Maltës.

Eksperienca “Job Shadowing” në Malta për mua mbetet më e bukura në disa aspekte:

Në aspektin social: U njohëm me njerëz të rinj pjesë e grupit prej 20 mësues dhe mësuese nga 6 vende të Ballkanit përëndimor, me të cilët u bëmë miq dhe mbajtëm kontakte për bashkëpunime të tjera.

Në aspektin profesional: Ishte një javë e planifikuar me trajnime me lektorë dhe lektore, koordinatörë dhe koordinatore të strukturës organizative të MCAST-it, të cilët na transmetuan modelin e funksionimit të institutëve në kampus, metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe shërbimet e ndryshme studentore. Ishte mbresëlënëse infrastruktura bashkëkohore teknologjike dhe laboratorike, si dhe ambjentete të mirëpajisura të klasave mësimore. U njohëm me modelin pedagogjik të mësimdhënies dhe gjithëpërfshirjes së studentëve në procesin e mësimdhënies dhe studimit.

Në aspektin kulturor: Ishte mahnitëse vizita në Valleta dhe Medina, qytete me një trashëgimi kulturore, historike dhe turistike. Por mbresëlënëse ishte arkitektura e ndërtesave dhe infrastruktura e qyteteve, ku ishin trashëguar të gjithë elementet kulturore dhe historike brez pas brezi. E paharueshme mbete vizita në katedralen St.John's në Valleta dhe atraksionet si: “Malta National Aquarium” dhe shumë të tjera.



Unë quhem Elona Kafexhiu dhe kam qenë përfaqësuese e Shkollës AFP “Sali Ceka” gjatë Job Shadowing organizuar në Kolegjin MCAST në Maltë. Jam Koordinatore e Projekteve të shkollës dhe aktualisht mbaj detyrën e Zëvendës drejtoreshës në këtë shkollë.

Përvoja në Maltë më dha shumë përfitime të mundshme për rritjen time personale dhe profesionale, përfitime për stafin dhe shkollën time. Mora një pasqyrë mbi rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të stafit të kolegjit dhe departamenteve të tyre, kulturën e kolegjit dhe mjedisin e punës. Ky ishte një mundësi e shkëlqyer për të mësuar mbi sfidat e punës, sukseset si dhe për të krijuar lidhje afatgjata dhe profesionale mes të gjithë kolegëve. Ndërveprimi me kolegë nga kultura të ndryshme ishte një mënyrë ideale për të kuptuar, mësuar prej tyre dhe madje për të ndarë elementet tona të përbashkëta dhe unike të kulturës sonë.



Elona Kafexhiu- Shkolla e mesme profesionale “Salih Ceka” Elbasan

INTERVET WB LËVIZSHMËRIA E NXËNËSVE PËR TË MËSUARIT

Miraturar në vitin 2019, projekti INTERVET WB do të lejojë 360 studentë nga të gjitha shkollat e AFP të 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Serbi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnje) të kryejnë një praktikë 1 Mujore jashtë vendit dhe 56 nxënës me praktikë 3 Mujore.

Pas udhëtimeve në Sevilja të Spanjës, Milano të Italisë dhe Lyon të Francës, nxënësit fitues të Mobiliteteve nga Shkollat Profesionale të Shqipërisë u akomoduan pranë kompanive ku ato do të realizonin praktikat 1 dhe 3 mujore. Një mjedis, kulturë ndryshe i priste nxënësit. Kjo ishte eksperiencia e tyre e parë e tyre larg familjes, ato do të kujdeseshin vetë për të gjitha nevojat, sfidat me të cilat do të përballeshin.



Une jam Xhurian Shaba, nxënës në klasën e 11 në shkollën “Hermann Gmeiner” ku vazhdoj studimet për IT. Si shumë bashkëmoshatar të mi edhe unë kisha dëshirën për të realizuar një internship në një nga vendet e Bashkimit Europian. Fatmirësisht shansi erdhi nëpërmjet Albanian Skills, një organizate që unë i jam shumë falenderues për mundësinë që më ofruan për të praktikuar profesionin tim për një muaj në Seville, Spanjë.

Unë nuk mund të gjej fjalët të cilat mund ta përshkruaj këtë experientë, por ajo që mund të them me siguri është që kjo praktikë është një hap gjigand në karrierën time. Njohja e kulturave të huaja dhe cdo gjë që i rrethon ato si gjuha, ushqimi, arkitektura dhe shoqërisë ishte e mrekullueshme. Falë punës së mrekullueshme të organizatës pritese (Incoma) dhe Albanian Skills këtë experientë do ta mbaj mend përjetë.

Vendi i punës ku unë zhvilloja praktikën sëbashku me një nxenës tjetër i pershtatej profilit tim shumë mirë dhe mësova edhe gjëra të tjera të cilat i bëra pjesë e bagazhit tim të aftësive. Njerezit aty ishin shumë mikëpritës dhe minimizonin efektet negative të barrierës së gjuhës.

Kjo eksperience ishte fantastike. Munda të formoj shoqëri që e di që do me zgjasin përjetë, u argetova, eksploroja një nga qytetet më të bukura të Spanjës ku ne mendje me kan mbetur disa pika turistike si: Plaza de Espana, Katedralja e Seville, Muse de Belle Artes, Alcazar Palace, etj , krijova kujtime të paharueshme, mesova njohuri të reja, mesova fjalë të një gjuhe të re, gatova me shoqet e dhomes, komunikova me njerezit vendas, provova ushqime tradicionale dhe shumë e shumë gjëra të tjera që do me duhen me ditë të tera që ti tregoj.

Une kete eksperience jua sygjeroj të gjithëve. Eshte nje eksperience e paharrueshme, e mbushur plot me aventura, te qeshura e shaka dhe me momente te cilat kurre sdo ti harroni.

Nje falemderim per Ana Zaharian, Albania Skills, Intervet WB dhe Incoma.

Përhëndetje, unë jam Darti Lila, një 18 vjeç që studioj në Institutin Harry Fultz në degën elektronike.

Periodha njëmuore në Milano ishte fantastike për mua. Gjatë kësaj kohe tek kompania ku kam punuar zhvillova më shumë aftësitë e mia programuese dhe mora shumë njohuri të reja. Punonjësit atje ishin shumë miqësor dhe u bëni si një familje për mua. Milano është një qytet i bukur dhe nuk mendoj se duhet ta përshkruaj që ju të imagjinoni madhësinë e tij. Katedralja Duomo ngrihej mbi ndërtesat e vjetra, duke u dhënë një mundësi të mahnitshme atyre që u ngjiten për të parë të gjithë qytetin nga njëri skaj në tjetrin. Ishte thjesht fantaskike, jam shumë i lumtur që pata mundësinë të përjetoja një eksperience të tillë.



**Xhurian Shaba, Shkolla Austriake TIK
"Hermann Gmeiner" Tiranë**



**Flavia Hysenliu, Shkolla Austriake TIK
"Hermann Gmeiner" Tiranë**



Darti Lila, Instituti Harry Fultz Tiranë





Une jam Rubin Vrapit nxenes I shkolles profrsionale Sali Ceka dhe jetoj ne qytetin e Elbasanit. Une u informova per projektin Intervet nga mesueset ne shkollen time dhe fitova mobilitetin ne Spanje Sevilla.

Sevilia ishte nje qytet shume I madh dhe I bukur. Banoret ne Sevilia ishin shume miqesore dhe I perkisnin nje kulture te vjeter dhe interesante per cdo vizitor. Vendi ku une realizova praktiken time ishte nje restorant dhe u mora me graphic design dhe video editing.

Per mua kjo ishte nje ekperience e re dhe shume e rendesishme sepse me ane te saj kuptova se cfare do te thote te punosh dhe te jetosh pa familjen . Kjo mundesi me ofroi njohuri te reja dhe disa miq te rinj me te cilet ja kalova shume bukur deri ne momentet e fundit. Kjo experience nuk ndikoi ne procesin tim mesimor dhe une ia kam sygjerruar kete projekt shume bashkemoshatareve te mi sepse ka perfitime sociale , dhe profesionale.



**Rubin Vrapit- Shkolla Profesionale
"Salih Ceka" Elbasan**

Jam Firdeus Kasaj, nxënës në klasën e 12-të në shkollën Hermann Gmeiner.

Në rrugëtimin e dijes, kisha ëndërruar të isha pjesë e eksperiencave dhe intershipeve të reja, ku përveç zgjerimit të njohurive, kishim mundësinë të njihnim vende të reja, me kultura të ndryshme.

Unë u përzgjedha për të qenë pjesë e "El Garbo de Greta" një faqe interneti dhe kompani e tregtisë elektronike.

Emri dukej si teatër ose tipik si titull filmi kinemaje.

Francisco Javierr Gutierrez Gandia, kreu i kompanisë me një emër që tingëllonte me një muzikalitet të veçantë, më kishte krijuar komoditetin e punës si anëtar jo vetëm i grupit të punës, por i një familjeje të vërtetë.

Çdo ditë më duhej të merrja transportin publik dhe të paraqitesha në orën 9:30 në kompani.

Puna në kompani më dha mundësinë të eksploroja, të zhvilloja opinionin tim dhe mbi të gjitha të mësoja shumë, mbi të gjitha të mësoja si të bëhesha pjesë e një grupi pune.



**Firdeus Kasaj, Shkolla Austriake TIK
"Hermann Gmeiner" Tiranë**

Ndihem shumë i privileguar që e kam rrëmbyer këtë mundësi me të dyja duart!

Gjithçka filloi pas marrjes së një konfirmimi për programin e intershipit në Spanjë, Sevilje nga Intervet WB. Papritur kuptova se kjo do të ishte një nga sfidat më të mëdha që më është dashur të përballem ndonjëherë. Ishte e frikshme, por edhe emocionuese të mendoja se do të isha student i huaj për një muaj, veçanërisht pasi do të ishte edhe hera ime e parë që do të largohesha vetë nga vendi im. Tani jam në gjendje ta shoh atë si një mënyrë mësimi për jetën time, si dhe një përvojë absolutisht fantastike që e vlerësova dhe e pëlqeva çdo minutë.

U përfshiva vërtet në atmosferën e krijuar nga studentët dhe shoqëria Erasmus. Programi orientues më dha mundësinë të mësoja më shumë për kulturën spanjolle, qytetin e bukur të Seviljes dhe gjithashtu më ndihmoi të takohesha dhe të ndërveproja me njerëz që do të bëheshin miq dhe pjesë e familjes sime Erasmus gjatë atij muaji!



**Fiori Kateshi, Shkolla Austriake TIK
"Hermann Gmeiner" Tiranë**



Ekspierenca e shoqërueses të Grupit ne Sevilla

Une jam Sibora Lohja, dhe studioj ne fushen e Mjekesise. Nje dite pashe nje lajmerim te organizates "Albanian Skills" per nje projekt 1 mujor, ne te cilin kerkohej nje teamleader per studente te cilet do benin praktike ne Seville.

Kjo experience me ka zhvilluar ne shume aspekte te jetes. Me ka mesuar si te jetoj e pavarur, te kujdesem jo vetem per veten time, por edhe per 10 studente, si te pershtatem me qytete dhe kultura te reja, dhe si te sillem si "Vajza Spanjolle". Kultura, arkitektura, historia e qytetit, njerezit e sjellshem dhe miqesor, jane gjera qe me te vertete me bejne te mendoj jetesen time ne Seville ne nje te ardhme.

Shoqerimi i 10 studenteve, te moshave 16-19, ishte nje experience emocionuese per mua. Jam perballur me 10 personalitet te ndryshme, duke u perpjekur te pershtatem me secilin nga to dhe te kuptoj mendimet dhe boten e tyre te brendshme. Studentet kane qene shume bashkepunues ne kete aspekt. Ne e shijam shume qendrimin tone atje.

Përsëndetje! Mua me quajnë Amisa Topalli dhe jam në vit të tretë të gjimnazi profesional "Hermann Gmeiner". Përgjatë kësaj përvoje unë mësova se si të përdorja printer 3D dhe specifikat e tij, u futa në Wordpress gjë që më përpara nuk i dija. Kjo është një ekspëriencë të cilën unë ua kam sygjerruar të gjithë bashkëmoshatarëve të mi pasi vjen vetëm një herë në jetë dhe është një hap i mirë për karrierën tonë si të rinj.



Sibora Lohja



4 TRANSNATIONAL MEETING NË TIRANË; INTERVET WB

Transnational Meeting në kuadër të projektit Intervet Western Balkan u mbajt përgjatë datave 15-16 Nëntor 2022 në Shqipëri, Tiranë, pranë ambienteve të Albanian ITC Academy, e cila është një akademi inovatore në fushën e Teknologjisë për të gjitha grupmoshat e nxënësve.

Të katërmbëdhjetë organizatat e projektit Intervet WB nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet Europiane ishin pjese e takimit.

Dita e parë e takimit nisi me shumë entuziazëm nga të gjithë pjesëmarrësit. Një ritakim mjaft i ngrohtë dhe emocionues për të gjithë. Takimi u hap nga Drejtorja Ekzekutive e organizatës pritëse Albanian Skills, Ana Zacharian e cila i uroi mirëseardhjen të gjithë pjesëmarrësve dhe nëpërmjet një prezantimi të shkurtër shfaqti eksperiencën e kaluar me projektin INTERVET përmes këndvështrimeve të nxënësve, mësuesve dhe aktorëve të përfshirë në projekt. Gjithashtu prezantoi dhe falenderoi përzemërsisht Albanian ICT Academy për bashkëpunimin në realizimin e këtij takimi dy ditor.



Më pas takimi vijoi me shtyrtime të temave të programit ku u diskutua për hapat e ardhshëm të projektit, amendimet e projekt buxhetit, të prezantuara nga Annalisa Palano, dhe Eleonora Tagliavini. Gjithashtu sesionet gjatë të cilave pjesëmarrësit u ndanë në grupe dhe diskutuan rreth praktikave më të mira nga organizatat pritëse dhe parapërgatitjet të pyetësorit nga organizatat dërguese. Gjithashtu gjatë pjesës së dytë të ditës u diskutua rreth politikave nacionale për sistemin Vet dhe ndikimi në mobilitete. Gjatë këtij sesiioni ishin të ftuar dhe përfaqësues nga Shkolla “Teknike Ekonomike Tiranë” dhe “Teknike Elektrike Gjergj Canco” ku mësueset treguan konkretisht sfidat, vështirësitë, ecurinë që kanë patur gjatë mobiliteteve me nxënësit.

Pas një diskutimi, reflektimi, ndarje mendimesh, gjetjen e mënyrave për të përmirësuar sfidat e hasura etj., dita e parë u mbyll me dhënien e rezultateve nga përfaqësuesi i MCAST Louis Aquilina për Job Shadowing (në shqip Punë në Hijë) e realizuara deri më tani.





Dita e dytë e 4 Transnational Meeting nisi herët në mëngjes me ndarjen në grupe dhe diskutimin, ndarjen e ideve rreth eventit final që do të mbahet në Bruksel, pyetësorit rreth rezultateve të arritura deri më tani nga organizatat dërguese të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Më pas vijoi me diskutimin rreth organizimit e pre departure meeting dhe diferencave kulturore. Në fund kjo ditë u përmbyll me vizitën në dy shkolla të arsimit profesional: Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë dhe Shkollën Teknike Elektrike Gjergj Canco, ku partnerët u njohën me historikun e shkollave, panë nga afër ambientet ku nxënësit realizojnë një pjesë të praktikave profesionale, u njohën nga afër me eksperiencat e nxënësve pjesmarrës në mobilitete etj.



Këto dy ditë kaluan shumë shpëjt dhe të gjithë dhanë kontributin e tyre në çdo session të mbajtur. Për ne si Albanian Skills ishte kënaqësi të ishim organizata pritëse dhe të mikprisnim në Shqipëri partnerët e Projektit Intervet Western Ballkan.






PËRVOJA E STUDENTËVE ITALIANË NË REALIZIMIN E PRAKTIKËS PRANË KOMPANIVE SHQIPTARE

Një eksperiencë ndryshe për herë të parë në Shqipëri nxënës të shkolla profesionale nga vendet e Bashkimit Europian vijnë dhe realizojnë praktikën e tyre 1 mujore pranë kompanive Shqiptare, Tiranë. Për ne ishte një kënaqësi e vecantë që të mirëprisnim grupin e parë të nxënësve nga Italia në Tiranë. Një grup prej 8 nxënësish realizuan praktikën e tyre në kompanitë si: Go Letto; Albanian ICT Academy; Expocity Albania; Alcomm, Albanian Skills.

Gjatë kësaj periudhe të kaluar në Shqipëri nxënësit kanë nëpërmjet disa artikujve të shkurtër do t'i lexoni më poshtë, kanë shprehur dhe mendimet, emocionet e kaluara.



NICHOLAS FARES“

Para se të nisesha për në Shqipëri, të them të drejtën, kam qenë i njëanshëm në disa aspekte sociale, siç është qëndrimi i njerëzve ndaj italianëve ose mbi ndarjen dixhitale të kompanive ose të vendit në përgjithësi. Kaloni disa javë, më duhet të ndryshoj mendje. Njerëzit këtu në Tiranë janë shumë të sjellshëm dhe mikpritës, dhe kompania ku unë punoj përbëhet nga punonjes kompetentë. Si përfundim, po jetoj një përvojë të mirë.”





NJUSTUS EMOHARE

“Para se të vija mendoja se ishte një vend ku njerëzit janë shumë të korruptuar, por ajo që pashë veçanërisht në Tiranë më bëri të kuptoj se është krejt e kundërta dhe se njerëzit janë shumë të sjellshëm dhe mikpritës.”

JEREMY GJYZELI

“Duke qenë me origjinë shqiptare dhe me njohuri për Shqipërinë, e dija tashmë se çfarë do të prisja. Kështu që isha mjaft i qetë dhe optimist për Shqipërinë, një vend shumë paqësor dhe jo aq i rrezikshëm sa mund të mendojnë disa”.

PAOLO CRISTOFORI MARINUCCI

“Prindërit e mi para se të nisesha kishin paragjykitime për shqiptarët sepse në Itali e kanë caktimin se nuk ishin shumë paqësorë dhe më pas për faktin se Shqipëria ishte një vend i prapambetur dhe në luftë. Gjërat kanë ndryshuar dhe e pashë sapo mbërrita, njerëzit janë të disponueshëm dhe me diell, qyteti është në zhvillim të vazhdueshëm dhe nuk dëshiron gjithmonë të ndalet”.

SINGH KARAMVEER

“Para se të nisesha për në Shqipëri, unë dhe familja ime nuk ishim shumë të kënaqur dhe nuk ishim të sigurt për destinacionin ku do të shkoja për të bërë Erasmus + por pavarësisht kësaj u largova. Sapo mbërrita në kryeqytetin Tiranë, që në fillim pashë gjëra që vërtet ishin WOW është një qytet i zhvilluar, i pastër dhe modern. Duke ardhur këtu në Shqipëri ndryshova mendim për ta, ata janë njerëz shumë të sjellshëm, mikpritës, të sjellshëm dhe të bukur. Duke qëndruar këtu mund të kthehem në Itali duke u thënë të gjithëve se kam pasur një përvojë të mrekullueshme dhe të paharrueshme.





GREGORIO CELANI

“Mendimi im për Shqipërinë para se të vija ishte mjaft i mirë, duke pasur parasysh se do të shkonim në kryeqytet, e vetmja frikë lidhej me njerëzit që jetonin atje dhe mund të ndodhte diçka e keqe. Megjithatë, tani që jam këtu, mund të them se njerëzit këtu në Shqipëri janë shumë të sjellshëm dhe ndihmues dhe se frika ime është zbutur plotësisht”.

ILARIA ODDI

Para se të largohesha, kisha frikë nga vendi ku do të shkoja, sepse isha plot paragjykime, për të cilat më kishin thënë, për njerëzit dhe vendet. Me të mbërritur këtu ndryshova krejtësisht mendimin tim: njerëzit janë të gjithë shumë të sjellshëm dhe mund të gesh kaq shumë kultura për t'u zhytur. Ky vend ishte vërtet një zbulim i madh.





JACOPO SCARPONI

“Para se të nisesha për në Shqipëri mendoja se po shkoja në një qytet të rrezikshëm (qoftë vetëm për faktin se është një qytet Tirana). Megjithatë, bazuar në përvojën time, mund të them se kam takuar njerëz të sjellshëm, mikpritës dhe të këndshëm.”

"EDOARDO MANZI

Unë jetoj në një qytet mjaft konservator ku njerëzit zakonisht shohin të huajt me mosbesim. Unë kurrë nuk kam pasur probleme me njerëz nga vende të tjera, por disa nga të afërmit e mi ishin pak mosbesues që unë do të merrja pjesë që të kujdesesha për tetë adoleshentët në Shqipëri. I kushtova pak vëmendje këshillave të tyre dhe u nisa për në Shqipëri. Edhe i vetmi vend që kam vizituar është Tirana, më pëlqen shumë Shqipëria, ishte dashuri me shikim të parë. Është një qytet vërtet modern me çdo rehati në majë të gishtave dhe me një çmim vërtetë të arritshme. U bëra shumë kurioz për historinë e Shqipërisë e cila ishte shumë interesante dhe kishte dhe lidhje me Italinë.





NE NUMRIN E ARDHSHEM

Përvojat e mësuesve gjatë Summer School në Malte

Mbyllja e thirrjes së tretë për Summer School në kuadër të projektit INTERVET. Me këtë thirrje do të përzgjidhen 3 mësues nga të gjitha shkollat profesionale të Shqipërisë.

Në numrin tjetër do të keni dëshmi të mësuesve për eksperiencën të cilën ato do të kalojnë. Ndjesitë pozitive, emocionete bukura, sfidat që kanë kaluar përgjatë kësaj eksperience.

Ditët e Karrierës pranë Bashkive të ndryshme në Shqipëri.

Nisma për Ditët e Karrierës do të vijojë dhe në Bashki të tjera vitin që po vjen. Nëpërmjet një artikulli do të lexoni për eksperiencë e kaluar nga trajnerë dhe pjesëmarrës gjatë këtyre ditëve.



Studentët nga Italia --Përvojat e tyre gjatë qëndrimit dhe praktikave profesionale në Tiranë, Shqipëri, në kuadër të Erasmus+

Përgjatë muajve Shkurt-Mars 2023 Albanian Skills do të mikpres studentë nga Italia të cilët do të realizojnë praktikat profesionale njëmuajore pranë kompanive shqiptare.

"Expo Punësim dhe Aftësi Profesionale 2023"

Gjatë datave 10-11 Shkurt 2023 do të mbahet panairi Expo Punësim dhe Aftësi ku Albanian Skills do të realizojë aktivitete të ndryshme.

